



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Drejtoria e Mbikëqyrjes së të Licencuarve dhe Inspektimeve

Nr. 983 prot.,

Tiranë, më 26.03.2026


PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2026


Drejtoria e Mbikëqyrjes së të Licencuarve dhe Inspektimeve

Në mbështetje të Përcaktimeve të të Vendimit nr.21 datë 27.01.2026 të Bordit të ERE-s “*Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Energjisë*” ku ndër të tjera janë përcaktuar funksionet, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së të Licencuarve dhe Inspektimeve, janë përpiluar detyrat e reja që duhet të ndjek drejtoria për pjesën e mbetur të vitit 2026, si vijon:

- Mbikëqyrja dhe inspektimi administrativ/teknik i subjekteve të licencuara në veprimtarinë e prodhimit/tregtimit/ furnizimit të energjisë elektrike.
- Përgatitja dhe përditësimi periodik i një database mbi raportimet mujore dhe progresive për periudhën e mbetur të vitit 2026 për sa i përket subjekteve të licencuara në veprimtarinë prodhimit/tregtimit/furnizimit të energjisë elektrike dhe kushteve që ato mund të disponojnë.
- Përgatitja e raporteve dhe informacioneve periodike për Bordin mbi inspektimet e kryera në subjektet e licencuara në veprimtarinë prodhimit/tregtimit/furnizimit të energjisë elektrike.
- Pjesëmarrje në mbledhjet konsultative e gjithashtu në mbledhjet e Bordit që do të zhvillohen përgjatë vitit 2026 në varësi të praktikave që ndiqen nga DMLI.
- Ndjekja e të gjitha korrespondencave që paraqiten për trajtim pranë Drejtorisë, apo bashkëpunimi me Drejtoritë e tjera sipas nevojave të punës. Zbatimi i të gjitha detyrave të ngarkuara për ndjekje rast pas rasti.
- Ndjekja e seancave dëgjimore që mund të organizohen/planifikohen gjatë vitit për çështje që i ngarkohen DMLI për ndjekje.
- Përgatitja e informacionit për Bordin mbi analizën e punëve për 3 mujorin e dytë, të tretë dhe të katërt të vitit 2026 nga drejtoria DMLI në zbatim të Rregullores së Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

- Bashkëpunimi, koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave me strukturat e ERE-s sipas planeve të punës të miratuara për këtë qëllim.

Rakordoi: J. Goxhaj 

Miratoi: J. Goxhaj 
Drejtore

Drejtorja e Mbikëqyrjes së të Licencuarve dhe Inspektiveve

E. B. Radheshi
Sekretar i Përgjithshëm